



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE**  
**LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Mbështetur në nenin 4, pika 3, germa “c” të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ndotura”, i ndryshuar, Ekipi Përzgjedhës shpall konkurrim për vendin vakant të:

- 1 Anëtari të Komisionit Kombëtar të Entit Rregullator të Ujit, profesionist sipas përcaktimeve në përputhje me germën “b” të pikës 3 të nenit 4 të Ligjit Nr. 8102 si dhe mandat me kohëzgjatje në përputhje me nenin 4 pika 3/d e po këtij ligji“
- Kandidati për Anëtar i Komisionit Kombëtar të Entit Rregullator të Ujit, në përputhje me germën “b” të pikës 3 të nenit 4 të ligjit 8102, duhet të jetë profesionist i kualifikuar me diploma universitare dhe të paktën 10 vjet përvojë në ekonomi, biznes, sistem bankar, kontabilitet, drejtësi, administratë publike apo disiplina të tjera të ngjashme.

Personat e interesuar të paraqesin kërkesën e tyre, të shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

- 1- Deklaratë që kandidati garanton plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 si dhe legjislacionit në fuqi, për Anëtar i Komisionit të sipërpërmendur.
- 2- Curriculum Vitae.
- 3- Kopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
- 4- Dokumente zyrtare që vërtetojnë njohjen e gjuhëve të huaja.
- 5- Certifikata të kualifikimeve të ndryshme.
- 6- Librezë pune (fotokopje të noterizuar)
- 7- Certifikatën e Gjendjes Gjyqësore ose Formularin e vet deklarimit të gjendjes gjyqësore dhe kopje të kartës së identitetit.
- 8- Formularin e vet deklarimit për zbatimin e Ligjit Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Dokumentet do të dorëzohen për Ekopin Përzgjedhës brenda datës **12.04.2021**, në adresën:

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, (ERRU) Rr. "Viktor Eftimiu", ish godina e KESH, nr. 1, kati i katërt, Tiranë.